



Një firmë farmaceutike zvicerane ka filluar të prodhoj një ilaç të ri të quajtur "Ilaçi Kur'anor" i cili mundëson shërim efikas të shikimit të dobët, pa ndërhyrje kirurgjike. Siç shkruan gazeta Ar-Raya e cila botohet ne Katar: "Ky ilaç, të cilin e ka zbuluar doktori egjiptian Abdul Basit Muhammed nga sekrecioni i gjëndrës së djersës të njerëzve, ka sukses në 99% të rasteve pa kurrfarë pasojash të pa dëshiruara. Ilaçi Kur'anor është i regjistruar në Evropë dhe SHBA." Po ashtu thuhet se një nga firmat zvicerane këtë ilaç e prodhon në formë të lëngët dhe pika.

Burimi i inspirimit është kaptina Jusuf. Dr. Abdul Basit Muhammed theksoj se inspirimin e tij e ka fituar nga kaptina Jusuf dhe tha: "Një mëngjesë derisa po lexoja kaptinën Jusuf, më tërhoqi vëmendjen ajeti 84. dhe ajetet që pasojnë".

Dhe, ua ktheu shpinën e tha: "O dëshpërim i im për Jusufin, dhe nga pikëllimi iu zbardhën të dy sytë, po i përmbajtur (nga pikëllimi).(Jusuf, 84)

Ju shkoni me këtë këmishën time, dhe hidhjani atë babait tim në fytyrë, e atij do t'i kthehet të pamët, e pastaj ejani tek unë me tërë familjen time".(u nisën) Dhe posa u ndanë devetë (prej qytetit), i ati i tyre tha: "Unë po e ndiej erën e Jusufit, mos më konsideroni të matufosur." (këtë ia tha familjes së vet në Palestinë). Ata (që ishin prezent) thanë: "Për All-llahun, ti vërtet qëmoti në humbje". E kur erdhi myzhdexhiu, ia vuri atë (këmishën) mbi fytyrën e tij, atij ju kthye të të pamët dhe tha: "A nuk ju thashë se

unë di nga All-llahu çka ju nuk dini?" (Jusuf, 93-96)

Në këto ajete tregohet se profeti Jakub a.s vuante për djalin e tij Jusufin a.s për të cilin kishte qarë shumë. Ai pikëllim aq i madh ishte shkak i sëmundjes së syve, ndërsa më vonë kur në sytë e pikëlluar të Jakubit a.s vendosën këmishën e Jusufit a.s, Jakubit a.s iu rikthye të pamurit .

Këtu kam filluar të mendoj. Çka mund të kishte në këmishën e Jusufit a.s ? Kam ardhur në përfundim se asgjë tjetër nuk mund të kishte përveç djerse. Pastaj kam filluar të mendoj për djersën dhe përbërjen e saj. Kam shkuar në laborator dhe kam filluar hulumtimet.

*Kam kryer një varg provash në lepuj. Rezultatet ishin pozitive. Më vonë kam kryer mjekimin e 250 pacientëve duke ju dhanë ilaçin dy javë nga dy herë në ditë. Kur kam arritur sukses në 99% të rasteve, i thashë vetes: **“Kjo është mrekulli nga Kur’ani”**.*

Dr. Abdul Basti Muhammed ju prezantoi rezultatet institucioneve përgjegjëse në Evropë dhe SHBA, të cilat mirën me licencimin e zbulimeve të reja. Pas kryerjeve të provave dhe studimeve, arriti marrëveshje me firmën zvicerane me kushtin që në ambalazh të ilaçit të shënoj qartë **“Ilaçi Kur’anor”**. Firma zvicerane kishte pranuar kushtin dhe filloj me prodhimin e ilaçit.

Allahu subhanehu we te'ala në Kur'an thotë: **“Ne të shpallim Kur'anin që është shërim dhe mëshirë për besimtarët, kurse jobesimtarëve nuk u shton tjetër përpos dëshprim.”**(Isra, 82)

Përktheu: Arsim SYLA